

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
AGJENCIONI KOSOVAR PËR PRONA, KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU, ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-245/15

Prishtinë,
16 Maj 2018

Në çështjen ligjore të:

N. T.

Pala ankuese

Kundër;

V. K.

Pala përgjegjëse në ankesë nr. 1

B.K.

Pala përgjegjëse në ankesë nr. 2

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i trupit gjykues, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08034), të datës 13 Mars 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 16 Maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga T. N., kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 Mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA08034, refuzohet si e pabazuar
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014, i datës 13 Mars 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numër, KPA08034.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 14 Dhjetor 2006, S. B. T. (në tekstin e mëtutjeshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP), me të cilën kërkonte ri-posedimin e ngastrave kadastrale nr. 943/1, me kulturë vneshtë, klasa II, në sipërfaqe prej 0.09.96 ha, ngastrën kadastrale Nr.943/2, me kulturë vneshtë e kl. II-të, në sipërfaqe prej 0.00.70 ha, dhe ngastrën kadastrale Nr. 943/3, me kulturë po ashtu vneshtë e kl. II-të, në sipërfaqe prej 0.00.70 ha, që ndodhen në vendin e quajtur “Kocasija” (në tekstin e mëtejme; prona e kërkuar).
2. Paraqitësi i kërkesës pohon se bashkëshortja e tij N.T. e lindur A, është pronare e palujtshërive të cekura, e njëjta posedimin e kishte humbur si pasojë e rrethanave që lidhen me konfliktin e armatosur, kurse tani prona është e uzurpuar.
3. Poashtu sqaron se e drejta pronësore nga bashkëshortja e tij, është fituar në bazë të Aktvendimit mbi trashëgimin nga i ndjeri babai i saj J. A., i cili sipas fletës poseduese evidentohet si pronar i pronës së kërkuar.
4. Së bashku me kërkesën ai kishte dorëzuar në AKP *inter alia* dokumentet vijuese;
 - Fotokopjen e Certifikatës nga Libri amë i të martuarve nr. I ref.119 i datës 28 Prill 1963 ,nga e cila vërtetohet se paraqitësi kërkesës është bashkëshorti i trashëgimtares N. T.
 - Kopjen e Listës Poseduese Nr. 2374, të lëshuar nga Enti Republikan i Gjeodezisë Beograd –Qendra për kadastër të pa luajtshmërive Prishtina me 22 Qershor 2004, në të cilën figuron se A. G. J, ishte pronar i pronës së kërkuar.
 - Aktvendimin mbi Trashëgimin O.br.3828/04, të datës 06 dhjetor 2004 të nxjerrë nga Gjykata e dytë Komunale në Beograd, në bazë të cilit vajza e të ndjerit J. A. N. T. shpallet trashëgimtare e paluajtshmërive, sipas fletës poseduese nr. 2374,
 - Certifikatën e vdekjes nr. 00309, të lëshuar nga administrata e Qytetit të Beogradit-Cukarica me datën 26 tetor 2007 nga e cila dëshmohet se ushtruesi i kërkesës S. T., kishte vdekur me 20 tetor 2007 në Zarkovo-Cukarica.

- Certifikatën nga Libri amë i të lindurve nr. 200-13904/37804 në emër të N.T, të datës 24 shtator 2009 të lëshuar në Nish për komunën e Prishtinës.
 - Aktvendim i Trashëgimisë LPR.nr.9436/13, Ref.Os.br.1105/13 me përmbajtje të njëjtë lidhur me trashëgimin e pronës së kërkuar, nga vajza e të ndjerit J.A., N.T. e Lindur A., të është lëshuar edhe nga Noteri I. Ademi në Prishtinë me datën 20 qershor 2013,
 - Autorizimin Ov.nr. 51340/2 212 i datës 31 dhjetor 2012, me të cilin N. Ta. e autorizon avokaten V.D. ta përfaqësoj lidhur me kërkesat e ushtruara në AKP.
 - Certifikatën nga Libri amë i të lindurve nr. 200-13904/37804 në emër të N.T, të datës 24 shtator 2009 të lëshuar në Nish për komunën e Prishtinës.
5. Më datë 28 Dhjetor 2010, kërkesa ishte publikuar në gazetën e KPA-së numër 10, në buletin zyrtar të UNHCR, Komunë Prishtinë, Gjykatë Komunale, Ombudsperson, KCA, DRC dhe në zyrën e UNMIK, në Gracanicë. Notifikimi është konfirmuar për mes hartave e kadastrave, ortofotove dhe GSP Koordinatave. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, ka vizituar pronën e kërkuar me 15 janar 2013, në te janë gjet shtëpi të ndërtuara, oborre dhe rrugë, të cilat shfrytëzohen nga familja e B.K, dhe familja e G. K,(palë përgjegjëse në ankesë).
6. Me datën 15 Janar 2013, pala përgjegjëse Nr.1 ishte paraqitur në AKP dhe kishte pretenduar të drejtë ligjore mbi pronën, duke deklaruar se babai i tij G. K.e kishte blerë pronën e kërkuar në vitin 1989.
7. Në mbështetje të pretendimeve të tij në KPA ka paraqitur dokumentet si në vijim;
- Kontratën e Shitblerjes së datës 20 Qershor 1989, nga e cila shifet se G. K. e ka blerë një pjesë të pronës së kërkuar nga R. U. në vitin 1989, dhe ate sipërfaqen prej 400 m2, që konfirmohet me nënshkrimin e shitësit, blerësit dhe dëshmitarëve, si në kontratë.
 - Faturën e tatimit në pronë të datës 27 korrik 2009 .
 - Procesin e KEK nr.2949 e datës 26 dhjetor 1991, në emër të G. K. lidhur me posedimin e njehsorit Elektrik.
8. Me 15 Janar 2013, pala përgjegjëse Nr. 2 ishte paraqitur në Agjenci dhe kishte pretenduar të drejtë ligjore mbi pronën, duke deklaruar se pronën e kërkuar e ka blerë babai i tij i ndjerë në vitet e 70-ta dhe se ky është lindur në atë pronë. Ai thekson se posedon dokumentacionin e rregullt rreth kësaj prone dhe për këtë dëshmojnë edhe të gjithë banorët e vjetër të lagjes me të cilët kanë bashkëjetuar për më shumë se 40 vite. Në mbështetje të pretendimeve të tij në KPA ka paraqitur dokumentet si në vijim;
- Listën e Rexhistrimit të rrethit kadastral Prishtinë, Komuna kad. Prishtinë, Nr.860 në bazë të cilës dëshmohet se shtëpia në rr Avalla”, nr 113, në sipërfaqe prej 0.00.61 ha, dhe oborr në sipërfaqe prej 0.05.00 ha është në emër të K. N.M. (gjendja faktike e terrenit sipas matjeve të vitit 1983 nga enti për gjeodezi dhe fotogrametrike në Prishtinë, i përgjigjet pjesërisht ngastrës kad. Nr.943 ,sipas kadastrit zyrtar).
 - Faturat e Tatimit në pronë të datës 04 Mars 2013

- Kopjen e planit të Zonës kadastrale në Prishtinë të datës 24 Janar 2013
 - Deklarata e dëshmitarëve R. K. dhe H.H., të cilët dëshmojnë se i ndjeri M. K. (babai i palës përgjegjëse B.K.), e ka blerë pronën nga i ndjeri S. K. në vitin 1975.
9. Sipas raporteve të Verifikimit dokumentet kryesore në të cilat pala ankuese e mbështetë kërkesën e saj janë verifikuar pozitivisht. Nga procesi i rregullt i verifikimit nga sekretaria e AKP, është vërtetuar se në pronën e kërkuar janë të ndërtuara tri shtëpi, një pjesë është rrugë, të cilat shfrytëzohen nga palët përgjegjëse të cilët pretendojnë se këto prona janë blerë më herët nga shitësit (pala e tretë) në vitin 1989, përkatësisht në vitet e 70-ta. Të njëjtit në mungesë të dokumentacionit propozojnë të dëgjohen dëshmitarë fqinjët e tyre dhe personat që kanë njohuri për këtë çështje.
10. Pas përmbledhjes së pretendimeve dhe dëshmive të palëve në procedurë, (palës kërkuese dhe palëve përgjegjëse), dhe deklaratave të tyre të cilat ishin kontradiktore, ku pala kërkuese të drejtën e saj e mbështet në fletën poseduese dhe vendimin e trashëgimisë të verifikuar pozitivisht ,në anën tjetër gjendja faktike në teren dhe pretendimet e palëve përgjegjëse të cilët nuk kanë dokumentacion valid për të dëshmuar të drejtën e tyre por propozojnë dëshmitar lidhur me gjendjen faktike të pretenduar, dhe pasi që në anën tjetër pala kërkuese nuk arrin të siguroj dëshmitar lidhur me pretendimet e tij se prona është uzurpuar dhe humbur në vitin 1998-99 si pasoj e konfliktit, për të vërtetuar gjendjen faktike KKPK-ja, mbanë seancë dëgjimore me palët në procedurë dhe dëshmitarët, si në kuptim të nenit 11 par.6 të Rregullores së UNMIK 2006/50, e plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079& Ligji 04/L-115.
11. Më 13 Mars 2014, KKPK-ja, me vendimin e saj KPCC/D/A/228/2014 , pasi që kishte mbajtur seancë dëgjimore përfundimtare me datë 21 Janar 2014 e hedhë poshtë kërkesën, për shkak të faktit se kërkesa binte jashtë juridiksionit të Komisionit pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Në paragrafin 30 të vendimit grupor të KKPK-së, thuhet se “Komisioni konstaton se deklaratat e palëve përgjegjëse dhe dëshmitarëve se ata i shfrytëzonin pronat e kërkuara shumë vite para konfliktit janë të besueshme, nga këto rrethana konstaton se humbja e aftësisë për të ushtruar të drejtën pronësore nga mbajtësi i pretenduar i të drejtës pronësore, nuk ka qen si rezultat i rrethanave që lidhen ose janë shkak i drejtpërdrejtë i konfliktit. Nga këto rrethana komisioni vlerëson se kërkesa e paraqitësit nuk i ka përmbushë kushtet sipas nenit 3.1 paragraf 3, të Rregullores së UNMIK-ut,2006/50,e miratuar me Ligjin nr.03/L-079.
12. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 25 Shkurt 2015. E njëjta (N.T.), kishte paraqitur ankesë me datë 25 Shkurt 2015.

Pretendimet e palës ankuese

13. Pala ankuese e kundërshton në tërësi Vendimin e KKPK-së, për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave procedurale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike .
14. Sipas palës ankuese prindi i saj i ndjerë ishte pronar i pronës së kërkuar të cilën e ka trashëguar pas vdekjes së tij, që konfirmohet sipas Aktvendimit të lëshuar nga noter I. Ademi nr. 9436/13, ref.08 br.1105/13 me 20 qershor 2013, se gjer në kohën e konfliktit ka jetuar në Prishtinë dhe ka qenë në posedim të pronës së kërkuar gjer sa është detyruar të largohet, se tani pasi i janë ofruar mundësitë kërkon kthimin e kësaj prone të cilën nuk e ka tjetërsuar më parë, e as prindi i saj i ndjerë, tutje thekson se uzurpuesit e pronës nuk kanë dëshmi se e kanë blerë pronën e kërkuar dhe nuk posedojnë leje ndërtimi për shtëpitë e ndërtuara, të cilat kanë mundur të ndërtohen në atë mënyrë vetëm në rrethana të konfliktit 1998-99, se çështja është vendosur në bazë të dëshmive të dëshmitarëve të një anshëm ndërsa nuk i është dhënë mundësia që të propozohen dhe dëgjohen edhe dëshmitarët e palës ankuese.
15. Në fund propozon që Gjykata Supreme ta prish vendimin e KKPK-së, të aprovoj kërkesën e saj, dhe pasurinë e uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme t'ia kthejë në posedim ankuseses.

Arsyetimi ligjor

16. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës pretendimeve ankimore dhe sipas detyrës zyrtare si në kuptim të nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, gjykata gjen se ankesa është e pranueshme dhe e afatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së.
17. Gjykata Supreme, pasi shqyrtoi pretendimet në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, konstaton se Vendimi KKPK-së nuk është i përfshirë me asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe as nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Prandaj ankesa nuk mund të miratohet.
18. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja, ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe kërkesat për të drejtën pronësore “që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, apo që rezultojnë nga ai. Prandaj paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm titullin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, por edhe të dëshmoj se ai apo ajo nuk është në gjendje ti ushtroj këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me, apo rezultojnë nga konfliktin i armatosur.
19. Nga provat në shkresa të lëndës të dëshmuara dhe administruara nga KKPK-aj, pa dyshim vërtetohet se prona e kërkuara nuk ishte humbur si pasojë e konfliktit në Kosovë në vitet 1998-99, ashtu si pretendon pala ankuese, sepse e njëjta për veç se posedon fletën poseduese të vitit 2004, dhe Vendimin e Trashëgimisë të vitit 2013, që dëshmohet se është pronare e pronës së kërkuar, me asnjë provë dhe në asnjë fazë të shqyrtimit të kësaj çështje në AKP, nuk ka ofruar fakte apo dëshmitarë se e njëjta e ka pas në disponim dhe shfrytëzim pronën e

- kërkuar, në vitet 1998-99, po ashtu në këtë përudhë kohore edhe më herët prona e kërkuar nuk ishte në pronësi të saj, ende nuk ishte filluar apo rregulluar procedura e trashëgimisë.
20. Nga shkresat në dosje të lëndës, dhe në Vendimin grupor të KKPK-së, pa dyshim vërtetohet se palët përgjegjëse në ankesë si dhe dëshmitarët e marrë në pyetje në seancën verbale të mbajtur nga komisioni, si në kuptim të nenit 11.6 të Rregullores së UNMIK-ut, kanë dëshmuar se prona e kërkuar nga pala ankuese, është blerë nga palët përgjegjëse, dhe të njëjtit janë në shfrytëzim shumë vite para konfliktit, të cilët në AKP kanë ofruar dëshmitë e cekua si në parag.6-9, të arsytimit të këtij aktgjykimi, nga vërtetohet se edhe pse nuk paraqesin titull pronësor, janë prova që dëshmojnë për posedim të palujtshërive, ndërsa pala ankuese nuk ka propozuar asnjë dëshmitar lidhur me pretendimet e saj siç ka deklaruar se, pronën e kërkuar e ka vizituar dhe e ka pas në shfrytëzim gjer në vitin 1999, kur e ka humbur posedimin mbi të si pasojë e ndërlidhjes me konfliktin.
 21. Nga faktet e cekuar më lartë rezulton se pretendimet e ushtrueses së ankesës të cekura si në parag.14-16, të këtij aktgjykimi dhe të tjerat si në ankesë, kur thekson se, asaj nuk i është dhënë mundësia që të ofroj dëshmitar lidhur me pretendimet e saj, por vendimi bazohet vetëm në deklaratat e të paditurve (palës përgjegjëse në ankesë), Gjykata Supreme po ashtu i refuzon si jo të qëndrueshme, sepse vërtetohet se AKP në fazën e përpunimit të kërkesës dhe KKPK në seancën e mbajtur të 37-të, mbajtësit të drejtës pronësore-ankueses i është ofruar mundësia, por nuk ka propozuar asnjë dëshmitar dhe nuk ka ofruar asnjë provë në asnjë fazë të përpunimit të kërkesës së saj që do të dëshmonte lidhur me pretendimet e saj se pronën e ka shfrytëzuar para konfliktit dhe që e ka humbur si pasojë e konfliktit të vitit 1998-99, por të drejtën e saj e njëjta e bazon vetëm në dokumentet pronësore të cekura si më lartë që nuk janë kontestuese.
 22. Gjykata Supreme, vlerëson se pala ankuese nuk ka dëshmuar se humbja e posedimit të pronave të kërkuara ka të bëjë me konfliktin. Andaj padyshim vërtetohet se KKPK, si në vendimin e saj, me të drejtë dhe bazë ligjore ka marrë vendim të drejtë kur ka gjetur se kërkesa e palës kërkuese nuk është përmbajtëse ashtu si parashihet në nenin 3.1, parag 3., të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, andaj kërkesa si e tillë është hedhur poshtë, sepse pala ankuese nuk ka arritur ta dëshmojë humbjen e të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të vitit 1998/99. Prandaj ankesa është e pa bazuar dhe e njëjta refuzohet.
 23. Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
 24. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese, apo palës së interesuar lidhur me të drejtën pronësore dhe as nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës ushtrimin e një kërkesë para organit apo gjykatës kompetente, nëse vlerësohet me interes legjitim.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami , kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, referente e EULEX-it